





AUF



# TRAJNIME TË FRUARA NGA FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



[WWW.FGJH.EDU.AL](http://WWW.FGJH.EDU.AL)



FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA I UT-SË - FAQJA ZYRTARE



FAKULTETI.GJUHEVETEHUAJA.UT



Kjo broshurë promovuese u hartua për t'u ardhur në ndihmë mësuesëve të arsimit parauniversitar, në kuadër të projektit të financuar nga Agjencia Universitare e Frankofonisë (AUF): "Zhvillimi dhe gërshetimi i qasjeve të reja pedagogjike dhe teknologjike në mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhëve të huaja në sistemin parauniversitar në Shqipëri, si një zgjidhje për periudhën post COVID", për dhjetë modulet e ofruara nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka fituar të drejtën e ofrimit të trajnimeve në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësëve arsimorë, licensuar nga MAS me Nr. 555/68 Prot., datë 30.05.2022 dhe me Vendim Nr. 176 datë 20.05.2022 të Komisionit të Akreditimit të Programeve/Moduleve të Trajnimit.



Autorë të kësaj broshure janë:

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha, Dekan i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, anëtare e grupit të punës së projektit dhe trajnere për një modul;

Dr. Ogerta Koruti Stroka, Koordinatore e projektit, trajnere për disa module dhe lektore e lëndëve: Burimet e Informacionit dhe Teknologjitë e Reja në Mësimdhënie dhe Didaktikë e Gjuhës Angleze, në FGJH-UT;

Dr. Etleva (Kondi) Koni, anëtare e grupit të punës së projektit dhe lektore e lëndës Metodologji e mësimdhënies së gjuhës angleze, në FGJH-UT;

Dr. Elvana Shtëpani, anëtare e grupit të punës së projektit dhe lektore;

Prof. Asoc. Dr. Anida Kisi, anëtare e grupit të punës, trajnere për një modul dhe lektore e lëndëve: Burimet e Informacionit dhe Teknologjitë e Reja në Mësimdhënie dhe Didaktikë e Gjuhës frënge, në FGJH-UT;

Vasilika Mulla anëtare e grupit të punës së projektit dhe Përgjegjëse e Degës së Projekteve, në FGJH-UT,

Dejan Kushta, editori që punoi broshurën.

**Maj**

**Tiranë 2023**

# *Përmbajtja*

|                                                                                                                                                                     |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Hyrje.....                                                                                                                                                          | 4  |
| Mbi modulet e trajnimit.....                                                                                                                                        | 6  |
| Si të bëheni pjesë e moduleve të trajnimit.....                                                                                                                     | 9  |
| Moduli 1: Përkrahja e diversitetit.....                                                                                                                             | 10 |
| Moduli 2: Mësimi dhe vlerësimi i nxënësve nëpërmjet aplikacioneve Kahoot, Mentimeter, Quizlet.....                                                                  | 13 |
| Moduli 3: Përdorimi i platformës virtuale në mësimdhënie (Team, OFFICE 365).....                                                                                    | 16 |
| Moduli 4: Hartimi dhe realizimi i një projekti në mësimdhënien në klasë dhe në distancë.....                                                                        | 19 |
| Moduli 5: Mësimdhënia dhe të nxënësve bazuar në kompetenca dhe planifikimi i veprimtarive mësimore sipas nevojave të veçanta dhe niveleve të ndryshme mësimore..... | 21 |
| Moduli 6: Përdorimi i platformës virtuale në mësimdhënie (Classroom, Zoom, Blogger) dhe Micro-Bit.....                                                              | 24 |
| Moduli 7: Testimi dhe vlerësimi i të nxënësve si dhe nxitja e autonomisë së nxënësve bazuar në portofolin PEGJH.....                                                | 27 |
| Moduli 8: Menaxhimi i klasës dhe i konflikteve, mirëqenia e nxënësve në klasë.....                                                                                  | 30 |
| Moduli 9: Integrimi i koncepteve të barazisë gjinore në mësimdhënie.....                                                                                            | 33 |
| Moduli 10: Teknikat e të pyeturit dhe diskutimi.....                                                                                                                | 35 |



## Misioni

Pjesë e misionit të FGJH-së është të nxisë bashkëpunimin akademik me institucionet homologe dhe bashkëpunimin me institucionet qeveritare, organizata profesionale dhe komunitetet lokale për ndërveprimin në shoqëri dhe promovimin e shkëmbimeve gjuhësore, akademike dhe kulturore si edhe ofrimin e shërbimeve në mësim, përkthim, trajnim dhe ekspertizë në fushën e gjuhëve të huaja.



## Rreth FGJH



Fakulteti mbështet veprimtarinë e tij në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në aktet nënligjore në fuqi, në Statutin dhe Rregulloren e UT-së si dhe në rregulloren e fakultetit. Bazuar në Statutin e UT të vitit 2018, neni 12/5, FGJH ka të drejtë të lidhë marrëveshje me njësi të tjera kryesore të IAL-ve të tjera, vendase ose të huaja, institute kërkimore-shkencore, qendra kulturore me qëllim realizimin e aktiviteteve të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive kulturore.

## Stafi & Departamentet

FGJH ka pedagogë të kualifikuar dhe me përvojë shumëvjeçare në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, të cilët kanë merita për arritjet e shkëlqyera në fusha thelbësore të jetës shoqërore si dhe staf mbështetës që krijon një mjedis cilësor. Aktualisht në fakultet janë të punësuar 128 personel akademik efektiv, 110 personel akademik me kontratë dhe 37 personel ndihmës akademik e administrativ.



Fakulteti i Gjuhëve të Huaja përbëhet nga 7 departamente: Departamenti i Gjuhës Angleze; Departamenti i Gjuhës Frënge; Departamenti i Gjuhës Italiane; Departamenti i Gjuhës Gjermane; Departamenti i Gjuhës Spanjolle; Departamenti i Gjuhës Greke; Departamenti i Gjuhëve Sllave e Ballkanike.



# Mbi Modulet e Trajnimit



Trajnimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional janë procese të hartuara për të përditësuar njohuritë profesionale, aftësitë dhe qëndrimet e mësuesve në mënyrë që ata të përmirësojnë procesin e mësimdhënies. Trajnimet u ofrojnë mësime të mësimdhënësve njohuritë, shkathtësitë, aftësitë dhe kompetencat e rëndësishme për jetën e tyre profesionale. Trajnimet tilla janë të rëndësishme dhe pjesë të programeve të përgatitjes së vazhdueshme të mësuesve, veçanërisht për ato aspekte të mësimdhënies që kërkojnë më shumë aftësi për të sjellë shumëllojshmëri të praktikave mësimore. Pas trajnimeve mësuesit kanë një tjetër qasje ndaj mësimdhënies por edhe ndaj vetë trajnimeve në përgjithësi.



Në kuadrin e ndryshimeve të vazhdueshme në arsim për t'iu përgjigjur reformave të reja dhe kërkesave në rritje për mësues të aftë që të përgatisin individë me njohuri të qëndrueshme dhe aftësi praktike për të përballuar sfidat e shekullit të 21-të është e domosdoshme që mësuesit të mbështeten me trajnime për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm profesional të tyre. Modulet e ofruara nga FGJH-ja synojnë aftësimin e mëtejshëm të mësuesve të gjuhëve të huaja në realizimin me sukses të kërkesave të Strategjisë Kombëtare për Arsim 2021-2026.

Modulet tona synojnë që të zhvillojnë aftësi kryesore për një nxënie me jetëgjatësi si:

- a) aftësia për të komunikuar dhe për t'iu shprehur;
- b) aftësia për të menduar;
- c) aftësia për të nxënë;
- ç) aftësia personale;
- h) aftësia qytetare;
- e) aftësia digjitale.



# Mbi Modulet e Trajnimit



## Kush mund të ndjekë modulet e ofruara nga FGJH?

Përfituesit e mundshëm nga trajnimi janë:

- Mësuesit e arsimit fillor që japin lëndën e gjuhës së huaj;
- Mësuesit e lëndëve në fushën "Gjuhë dhe komunikim" (Gjuhë e huaj e parë dhe gjuhë e huaj e dytë) në arsimin e mesëm të ulët;
- Mësuesit e lëndëve në fushën "Gjuhë dhe komunikimi" (Gjuhë e huaj e parë dhe gjuhë e huaj e dytë) në arsimin e mesëm të lartë;
- Drejtuesit e shkollave 9- vjeçare të profileve: Gjuhë e huaj;
- Drejtuesit e shkollave të mesme të profileve: Gjuhë e huaj;
- Specialistët e DAR/ZA-ve të profileve: Gjuhë e huaj;
- Inspektorët e ISHA-s;
- Mësuesit e lëndëve shoqërore që kanë interes në hartimin dhe përdorimin e Portofolit në lëndën e tyre.



## Përfitimet e nxënësve në sistemin e arsimit parauniversitar nëpërmjet zhvillimit profesional të mësuesve të tyre nëpërmjet këtij programi/moduli trajnimi.

Zhvillimi profesional nëpërmjet moduleve të trajnimit do t'i ndihmojë mësuesit në përditësimin e aftësive të tyre dhe në përfitimin e aftësive të reja, duke i inkurajuar ata që vazhdimisht të vijnë me mënyra të reja të trajtimit të nxënësve. Trajnimi i mësuesve do të mundësojë përgatitjen e nxënësve sa më të suksesshëm në një botë që është çdo ditë në zhvillim. Nxënësit do të jenë të aftë në përdorimin e teknologjive të reja, do të mund të marrin arsimimin e duhur me qëllim përmbushjen e kërkesave të tregut, do të arrijnë të komunikojnë në mënyrë efikase dhe të mendojnë në mënyrë kritike për zgjidhjen e problematikave që do të hasin. Sa më shumë të zhvillohen mësuesit profesionalisht, aq më shumë rriten mundësitë e nxënësve që të jenë të suksesshëm.

# Mbi Modulet e Trajnimit



Nëse mësuesit do të përzgjedhin modulet e trajnimit të ofruara nga FGJH, ata mund të ndihmojnë nxënësit të fitojnë aftësi të cilat janë të domosdoshme për suksesin e tyre, si:

- Të përshtaten me ndryshimet e shpejta në kulturë dhe teknologji;
- Të jenë njohës dhe përdorues të mirë të teknologjive të reja;
- Të mendojnë në mënyrë kritike;
- Të zgjidhin problemet;
- Të ndërmarrin iniciativa;
- Të punojnë në grup;
- Të kenë aftësi drejtuese;
- Të rrisin aftësitë e tyre komunikuese në të folur e shkruar;
- Të jenë të aftë të gjejnë dhe analizojnë informacione të ndryshme.



# Si të bëheni pjesë e moduleve të trajnimit



Trajnimet do të zhvillohen si trajnim i drejtpërdrejtë ose trajnim në distancë (online).

- Çdo modul me 1 kredit, i barazvlefshëm në 18 orë trajnim (trajnim, përgatitje dhe përpunim njohurish).
- Çdo modul me 2 kredite, i barazvlefshëm në 36 orë trajnim (trajnim, përgatitje dhe përpunim njohurish).
- Çdo modul me 3 kredite, i barazvlefshëm në 54 orë trajnim (trajnim, përgatitje dhe përpunim njohurish).

Pagesa për trajnimin është 1000 lekë për çdo kredit.

Pagesat kryhen përmes llogarisë bankare të

Fakultetit të Gjuhëve të Huaja sipas mandat pagesës

- (mandat pagese 1 kredit)
- (mandat pagese 2 kredite)
- (mandat pagese 3 kredite).

**Skano Kodin për tu  
drejtuar në faqen e trajnimeve:**



[https://trajnime.arsimi.rash.al/Trajnimes/TrajnimeMesues?](https://trajnime.arsimi.rash.al/Trajnimes/TrajnimeMesues?SelectedQyteti&SelectedFushaModul&SelectedAgjensia=2102&item&fbclid=IwAR0RqMhECBwuPgOETTWY7ba9nnmNLwuyFzpYHfGrJlwHbtQW3SuUiq-2BDU)

[SelectedQyteti&SelectedFushaModul&SelectedAgjensia=2102&item&fbclid=IwAR0RqMhECBwuPgOETTWY7ba9nnmNLwuyFzpYHfGrJlwHbtQW3SuUiq-2BDU](https://trajnime.arsimi.rash.al/Trajnimes/TrajnimeMesues?SelectedQyteti&SelectedFushaModul&SelectedAgjensia=2102&item&fbclid=IwAR0RqMhECBwuPgOETTWY7ba9nnmNLwuyFzpYHfGrJlwHbtQW3SuUiq-2BDU)

Për më tepër informacion, mund të kontaktoni në adresën e-mail:  
[trajnimefgjh@unitir.edu.al](mailto:trajnimefgjh@unitir.edu.al)

# Moduli 1: Përkrahja e diversitetit



## Titulli i programit të trajnimit:

Përkrahja e diversitetit

## Lloji i Trajnimit:

Trajnim i drejtpërdrejtë

Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime

Trajnimi nëpërmjet internetit

## Nr i krediteve:

18 orë – 1 kredit



## Temat

- -Diversiteti dhe kodet kulturore në mjedisin shkollor;
- -Edukimi ndërkulturor dhe projektet shkollore;
- -Edukimi për qytetarinë- Konfliktet dhe zgjidhja e tyre;
- -Puna me stereotipet, paragjykimet dhe klishetë;
- -Diversiteti gjuhësor: qasje të të mësuarit nëpërmjet krahasimit të gjuhëve, burime informacioni dhe veprimtari;
- -Implicitet kulturore/ gjestet dhe komunikimi joverbal;
- -Dimensioni ndërkulturor në metodat e gjuhës së huaj dhe trajtimi i diversitetit;
- -Veprimtari pedagogjike dhe burime mbi diversitetin kulturor dhe gjuhësor;
- -Promovimi i të jetuarit së bashku, kundër racizmit dhe diskriminimit, nëpërmjet veprimtarive të ndryshme gjatë mësimit.



## Rezultatet e pritshme

Në përfundim të modulit pjesëmarrësit do të:

- konceptojnë veprimtari pedagogjike për nxënësit ku të trajtohet diversiteti kulturor dhe gjuhësor;
- trajtojnë veprimtaritë e ndryshme në metodat e mësimdhënies së gjuhëve të huaja në kuadër të të jetuarit së bashku;
- njohin qasjet e fundit kërkimore si edhe ato të institucioneve evropiane mbi këtë çështje;
- zhvillojnë një mendim kritik në kontekstin në të cilin japin mësim për të formuar nxënës qytetarë të hapur ndaj shoqërive, kulturave dhe gjuhëve të ndryshme;
- identifikojnë mënyrat përkatëse për zhvillimin profesional (në lidhje me pyetjen), të cilat mund t'i ndjekin më pas.

## Metodologjia

Gjatë trajnimit do të përdoren forma e metoda të larmishme:

- prezantime me Powerpoint nga trajnuesit;
- debate apo diskutime mbi tematikat e trajtuara;
- nxitja e reflektimit në auditor, shfrytëzimi dhe shkëmbimi i përvojës së mësuesve;
- punë me grupe, diskutim e debat për raportimin e punës së grupit mbi detyra që do të caktohen nga trajnerët;
- analizë e diskutime mbi materialet audio e video që do t'u vihen në dispozicion nga trajnerët si dhe mbi mënyrat e përdorimit të tyre;
- materiale pedagogjike që mund të prodhohen nga pjesëmarrësit gjatë trajnimit por edhe si detyra shtëpie në formën e një projekti përfundimtar.



## Literatura e rekomanduar

ABDALLAH-PRETCEILLE M. (1999), L'éducation interculturelle. Paris : PUF (Que sais-je ?).

Council of Europe (2009) Plurilingual and intercultural education as a project Commission européenne, Le dialogue interculturel dans les programmes de l'Union européenne, Communautés européennes, 2008. Téléchargeable en version pdf : [http://ec.europa.eu/dgs/education\\_culture/publ/pdf/eu-programmes/eyid\\_fr.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/publ/pdf/eu-programmes/eyid_fr.pdf)

Conseil de l'Europe, Livre blanc sur le dialogue interculturel, « Vivre ensemble dans l'égale dignité », juin 2008. Téléchargeable en version pdf : [http://ëëë.coe.int/t/dg4/intercultural/Source/Pub\\_Ëhite\\_Paper/Ëhite%20Paper\\_final\\_revise\\_d\\_FR.pdf](http://ëëë.coe.int/t/dg4/intercultural/Source/Pub_Ëhite_Paper/Ëhite%20Paper_final_revise_d_FR.pdf)

Huber-Kriegler Martina, Lázár Ildikó et Strange John, Miroirs et fenêtres – Manuel de la communication interculturelle, C.E.L.V., 2005. Téléchargeable en version pdf : [http://www.ecml.at/documents/pub123aF2005\\_HuberKriegler.pdf](http://www.ecml.at/documents/pub123aF2005_HuberKriegler.pdf)

Leclercq, Jean-Michel, Figures de l'interculturel dans l'éducation, Strasbourg : Conseil de l'Europe, 2003, 82 p.

[https://www.lepointdufle.net/penseigner/diversite\\_culturelle-fiches-pedagogiques.htm#cultures](https://www.lepointdufle.net/penseigner/diversite_culturelle-fiches-pedagogiques.htm#cultures) <https://www.cairn.info/revue-carrefours-de-l-education-2002-2-page-120.htm>



## Mbi trajnieren



**Prof. Dr.  
Esmeralda Kromidha**

- Prof. Dr. Esmeralda Kromidha është Dekan dhe Pedagoge e Didaktikës së gjuhës frënge në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës;
- Ajo është specialiste në lëndët e metodologjise dhe didaktikës së gjuhëve të huaja (lëndët Metodologji, Metodatat e Kërkimit Shkencor, Komunikimin dhe Edukimin Ndërkulturor, Didaktikë e Gjuhës së Huaj për Qëllime Specifike) hartuese programesh në Ciklin e Parë dhe të Dytë të studimeve universitare;
- Prof. Dr. Esmeralda Kromidha është autore e disa botimeve brenda dhe jashtë vendit në fushën metodikës dhe pedagogjisë së gjuhëve të huaja.
- Prof. Dr. Esmeralda Kromidha organizon dhe ndjek praktikantët mësimorë të studentëve të masterit, mësues kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- Ajo është trajnuese kombëtare dhe ndërkombëtare.

## *Moduli 2: Mësimi dhe vlerësimi i nxënësve nëpërmjet aplikacioneve Kahoot, Mentimeter, Quizlet*

The poster is for a training module titled "MODUL TRAJNIMI". It features the logo of the University of Tirana (Universiteti i Tiranës) in the top left and the logo of the Faculty of Education (Fakulteti i Shkencave të Edukimit) in the top right. The text on the poster reads: "Kanë filluar regjistrimet për: MËSIMI DHE VLERËSIMI I NXËNËSVE NËPËRMJET APLIKACIONEVE KAHOOT, MENTIMETER, QUIZLET (1 KREDIT)". Below this, it lists the trainers: "Trajnues: PROF. ASOC. DR. OGERTA STROKA (KORUTI) PROF. ASOC. DR. ELONA TORO". At the bottom, there is a QR code labeled "MË SKANO" and an illustration of a person at a computer. A small banner at the bottom right of the illustration says "1 KREDIT=1000L".

### **Titulli i programit të trajnimit:**

Mësimi dhe vlerësimi i nxënësve nëpërmjet aplikacioneve Kahoot, Mentimeter, Quizlet

### **Lloji i Trajnimit:**

Trajnim i drejtpërdrejtë

Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime

Trajnimi nëpërmjet internetit

### **Nr i krediteve:**

18 orë – 1 kredit

# Quizlet Kahoot! Mentimeter


### **Temat**

- Hyrje në Kahoot. Si hapim një llogari në Kahoot;
- Si krijohet një Kahoot! dhe si mund të gjejmë Kahoot-e të gatshme; Llojet e Kahoot;
- Si ruajmë, ndajmë dhe luajmë në kohë reale apo si e japim detyrë shtëpie një Kahoot;
- Hyrje në Mentimeter; si të hapim një llogari në Mentimeter;
- Si krijohet një Mentimeter! dhe si mund të gjejmë Mentimeter të gatshëm;
- Si ruajmë, ndajmë dhe luajmë në kohë reale apo si e japim detyrë shtëpie një Mentimeter;
- Hyrje në Quizlet; Si hapim një llogari në Quizlet;
- Si krijohet një Quizlet! dhe si mund të gjejmë Quizlet të gatshme;
- Si ruajmë, ndajmë dhe luajmë në kohë reale apo si e japim detyrë shtëpie një Quizlet.

## Rezultatet e pritshme

Në fund të Modulit pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

- përdorin burimet e teknologjisë me qëllim që të angazhohen në zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- përdorin teknika të reja mësimdhënieje në përditshmërinë e tyre;
- përdorin Kahoot, Mentimeter dhe Quizlet;
- ndërtojnë një Kahoot, Mentimeter dhe Quizlet;
- vlerësojnë nxënësin dhe t'i japin mundësi atyre të vetëvlerësohen me anë të aplikacionit Kahoot! dhe Quizlet.



## Metodologjia-Për trajnimin e drejtpërdrejtë

Gjatë trajnimit do të përdoren forma e metoda të larmishme si:

- prezantime me Powerpoint nga trajnuesi i cili do të bëjë demonstrime të drejtpërdrejta me platformën dhe aplikacionin e përzgjedhur;
- debate apo diskutime mbi nevojat e përdorimit të Kahoot!, Quizlet dhe Mentimeter dhe mënyrave se si mund të integrohen në mësimdhënie por jo vetëm;
- nxitja e reflektimit në auditor si edhe shfrytëzimi e shkëmbimi i përvojës së mësuesve mbi Kahoot!, Quizlet dhe Mentimeter;
- punë me grupe, diskutim e debat për raportimin e punës së grupit mbi detyra që do të caktohen nga trajnerët;
- analizë e diskutime mbi materialet audio e video që do të vihen në dispozicion nga trajnerët mbi mënyrat e aplikimit, integritit dhe përshtatjes për përdorim të Kahoot!, Quizlet dhe Mentimeter edhe nga nxënësit;
- materiale audio e video që mund të prodhohen nga pjesëmarrësit gjatë trajnimit por edhe si detyra shtëpie në formën e një projekti përfundimtar.


# Metodologjia-Online

*Për trajnimin nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime*

Edhe gjatë trajnimit online ku do të përdoret platforma Teams si aplikacion që do të ndërmjetësojë trajnimin e mësuesëve do të përdoren:


- prezantime me Powerpoint nga trajnuesi i cili do të bëjë demonstrime live me platformën dhe aplikacionin e përzgjedhur;
- debate apo diskutime mbi nevojat e përdorimit të Teams dhe Office 365 dhe mënyrave se si mund të integrohen në mësimdhënie por jo vetëm;
- nxitja e reflektimit online dhe shfrytëzimi dhe shkëmbimi i përvojës së mësuesëve mbi Kahoot!, Quizlet dhe Mentimeter;
- punë me grupe në dhoma virtuale, diskutim e debat për raportimin e punës së grupit mbi detyra që do të caktohen nga trajnerët;
- Analizë e diskutime mbi materialet audio e video që do të vihen në dispozicion nga trajnerët mbi mënyrat e aplikimit, integritetit dhe përshtatjes për përdorim të Kahoot!, Quizlet dhe Mentimeter edhe nga nxënësit.

## Mbi trajnerët



**Prof. Asoc. Dr.  
Ogerta Stroka (Koruti)**

- Ogerta Koruti Stroka është profesoreshe e Shkencave në Gjuhësi dhe Mësimdhënie në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës.
- Ogerta është pedagoge në Universitetin e Tiranës që nga viti 2005 e në vazhdim. Që prej vitit 2021 ajo është Zv Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Fusha e saj e ekspertizës është integrimi i teknologjive të reja në mësimdhënie.
- Ajo është E- Moderator, Master Trainer dhe Validator për British Council UK për Core Skills si Digital Literacy, Leadership Citizenship, Critical thinking, Problem Solving and Decision Making, Collaboration and Communication, Creativity and Imagination, Personal Development si edhe Presentation Skills.



**Prof. Asoc. Dr.  
Elona Toro**

- Prof. Asoc. Dr. Elona Toro, pedagoge në Departamentin e gjuhës frënge të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës jep lëndët e Mësimdhënies nëpërmjet Teknologjive të Informacionit dhe të Komunikimit si dhe të Frëngjishtes me Qëllime Specifike;
- Ajo ka përfunduar studimet universitare në vitin 2005 në Departamentin Gjuhës Frënge në Universitetin e Tiranës në fushën e përkthimit dhe interpretimit. Më vonë, ajo ndoqi një master në Përhapjen e gjuhës frënge, Frankofoni në Universitetin e Rouen-it dhe një master 2 në Didaktikë të Gjuhës Frënge në Universitetin e Sorbonës – Paris III;
- Prof. Asoc. Dr. Elona ka mbrojtur tezën e doktoratës në vitin 2017 mbi një temë që lidhet me përdorimin e TIK-ut për të përmirësuar trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve të gjuhës: “TIK -u dhe ndërtimi i njohurive në kuadrin e trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve të gjuhëve në Shqipëri”.

## *Moduli 3: Përdorimi i platformës virtuale në mësimdhënie (Team, OFFICE 365)*



### **Titulli i programit të trajnimit:**

Përdorimi i platformës virtuale në mësimdhënie (Team, OFFICE 365)

### **Lloji i Trajnimit:**

Trajnim i drejtpërdrejtë

Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime

Trajnimi nëpërmjet internetit

### **Nr i krediteve:**

**36** orë – 2 kredite

## **Temat**

- Hyrje në Teams, Mënyra e aksesimit e Microsoft Teams;
- Të njihemi me klasat Teams; Krijimi i klasave në Teams, Menaxhimi i klasave në Teams;
- Përditësimi dhe fshirja e klasave në Teams;
- Si të ngarkojmë dokumenta në Teams;
- Si të krijojmë një detyrë;
- Si të fshijmë një detyrë;
- Si të korrigjojmë dhe vlerësojmë një detyrë;
- Komunikimi në grupe publike dhe private;
- Si të iniciojmë një leksion në Teams;
- Si të skedulojmë një takim online me studentët;
- Hyrje në Office 365, Si të ruajmë dhe ndajmë materiale në Sharepoint;
- Office 365 Forms;
- Office 365 Polls;
- Office 365 Stream.




## Rezultatet e pritshme

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

- ndërtojnë një klasë në platformën Teams;
- vendosin detyra në klasat e tyre në Teams;
- korrigjojnë dhe vlerësojnë një detyrë;
- nisin një leksion online nëpërmjet Teams;
- ndërtojnë një pyetësor;
- ndërtojnë një quiz.



## Metodologjia



Gjatë trajnimit do të përdoren forma e metoda të larmishme:

- prezantime me Powerpoint nga trajnuesi i cili do të bëjë demonstrim të drejtpërdrejtë me platformën dhe aplikacionin e përzgjedhur;
- debate apo diskutime mbi nevojat e përdorimit të Teams dhe Office 365 dhe mënyrave se si mund të integrohen në mësimdhënie por jo vetëm;
- nxitja e reflektimit në auditor dhe shfrytëzimi dhe shkëmbimi i përvojës së mësuesve mbi Teams dhe Office 365;
- punë me grupe, diskutim e debat për raportimin e punës së grupit mbi detyra që do të caktohen nga trajnerët;
- analizë e diskutime mbi materialet audio e video që do të vihen në dispozicion nga trajnerët mbi mënyrat e aplikimit, integritit dhe përshtatjes për përdorim të Teams dhe Office 365 edhe nga nxënësit;
- materiale audio e video që mund të prodhohen nga pjesëmarrësit gjatë trajnimit por edhe si detyra shtëpie në formën e një projekti përfundimtar.

## Literatura e rekomanduar

Tech Tech Treck, 2020, Microsoft Teams For Educators: A Fundamental Guide to Mastering Microsoft Teams for Education with Step-by-Step Illustrations For Teachers Paperback

Corley Catherine, 2020, Microsoft Teams For Teachers: A Quick Reference Guide for Classroom Teachers, Educators and School Administrators,

Nordell Randy, 2019, Microsoft Office 365: In Practice, McGraw Hill

<https://clouddamcdnprodep.azureedge.net/gdc/gdcFTFAvL/original>


[https://www.ed.ac.uk/files/atoms/files/getting\\_started\\_with\\_microsoft\\_teams.pdf](https://www.ed.ac.uk/files/atoms/files/getting_started_with_microsoft_teams.pdf) [https://d2oc0ihd6a5bt.cloudfront.net/wp-](https://d2oc0ihd6a5bt.cloudfront.net/wp-content/uploads/sites/619/2018/02/Ultimate-guide-of-Microsoft-Teams.pdf)

[content/uploads/sites/619/2018/02/Ultimate-guide-of-Microsoft-Teams.pdf](https://oit.siu.edu/crc/_common/documents/training-files/microsoft-teams-training-guide.pdf)

[https://oit.siu.edu/crc/\\_common/documents/training-files/microsoft-teams-training-guide.pdf](https://oit.siu.edu/crc/_common/documents/training-files/microsoft-teams-training-guide.pdf)


[https://www.jcu.edu.au/\\_\\_data/assets/pdf\\_file/0019/653140/Microsoft-Forms-Quick-Guide.pdf](https://www.jcu.edu.au/__data/assets/pdf_file/0019/653140/Microsoft-Forms-Quick-Guide.pdf)

## Mbi trajnierët



**Prof. Asoc. Dr.  
Ogerta Stroka (Koruti)**

- Ogerta Koruti Stroka është profesoreshë e Shkencave në Gjuhësi dhe Mësimdhënie në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës.
- Prof. Asoc. Dr. Ogerta është pedagoge në Universitetin e Tiranës që nga viti 2005 e në vazhdim. Që prej vitit 2021 ajo është Zv Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.
- Fusha e saj e ekspertizës është integrimi i teknologjive të reja në mësimdhënie.
- Ajo është E- Moderator, Master Trainer dhe Validator për British Council UK për Core Skills si Digital Literacy, Leadership Citizenship, Critical thinking, Problem Solving and Decision Making, Collaboration and Communication, Creativity and Imagination, Personal Development si edhe Presentation Skills.



**Prof. Asoc. Dr.  
Anida Kisi**

- Prof. Asoc. Dr. Anida Kisi është e punësuar me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhës Frënge, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. Ka një përvojë pune 20-vjeçare si pedagoge dhe studiuese. Pas diplomimit në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim frëng, në vitin 2000, studimet pasuniversitare dhe ato doktorale lidhen me çështje të komunikimit, të stilistikës, të semiologjisë dhe të teknologjive në mësimdhënie.
- Fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë disiplina që lidhen me çështje të komunikimit në media, të komunikimit ndërkulturor, të stilistikës, dhe të teknologjive në mësimdhënie. Ka marrë pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si edhe ka botuar një sërë artikujsh shkencorë.
- Ka marrë pjesë në disa projekte kërkimore ndërkombëtare që prekin aspekte të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fushën e didaktikës së gjuhës së huaj, të komunikimit turistik, etj. Ka zhvilluar trajnime të shumta kombëtare dhe ndërkombëtare si trajnuese e Agjencisë Ndërkombëtare të Frankofonisë (AUF).

## Moduli 4: Hartimi dhe realizimi i një projekti në mësimdhënien në klasë dhe në distancë



### Titulli i programit të trajnimit:

Hartimi dhe realizimi i një projekti në mësimdhënien në klasë dhe në distancë

### Lloji i Trajnimit:

Trajnim i drejtpërdrejtë

Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime

Trajnimi nëpërmjet internetit

### Nr i krediteve:

18 orë – 1 kredit


### Temat

- Tema: Konceptimi dhe ndërtimi i një projekti klase
- Tema: Mjetet digjitale për krijimin dhe zbatimin e një projekti klase



### Rezultatet e pritshme

- Të njohë parimet e pedagogjisë sipas projektit;
- Të përvetësojë fazat e ndërtimit të një projekti në klasë;
- Të përcaktojë hapat për krijimin e një skenari hibrid/mësim në distancë;
- Të njohë dhe të përdorë aplikacione ueb për redaktimin dhe hartimin e dokumenteve audio, video ose imazhe;
- Të njohë mjetet për kryerjen e punës bashkëpunuese në internet;
- Të njohë aplikacionë digjitale për krijimin e aktiviteteve të vlerësimit në internet.



## Metodologjia

Trajnimi do të organizohet në formën e një prezantimi të elementeve të ndryshëm që përbëjnë një projekt klase duke marrë parasysh punën hibride ose në distancë.

Pjesëmarrësit në trajnim do të mësojnë parimet bazë të pedagogjisë së bazuar në projekte dhe hapat për krijimin e një projekti në klasë dhe një skenar pedagogjik specifik për mësimdhënien/të mësuarit online.

Gjatë këtij trajnimi ata do të njihen edhe me mjetet/aplikacionet digjitale të nevojshme për krijimin e një projekti në të gjitha fazat e tij (çaktimi dhe menaxhimi i detyrave, shkëmbimi i informacionit, bashkëpunimi ndërmjet pjesëmarrësve, redaktimi dhe manipulimi i dokumenteve multimediale, vlerësimi i projektit).

Në përpjekje për të krijuar një dinamikë ndërveprimi gjatë trajnimit, pjesëmarrësve do t'u kërkohej t'u përgjigjen pyetjeve dhe të bëjnë brainstorming përmes mjeteve online.


Trajnimi në thelb bazohet në metoda mësimore aktive dhe pjesëmarrëse. Një pjesë e madhe e trajnimit do t'i kushtohet praktikimit të koncepteve të paraqitura nga trajneri nëpërmjet aktiviteteve mësimore në formën e Punës Praktike.

Detyrat do të organizohen rreth një aktiviteti qendror që është shkrimi i një projekti në klasë. Dhe ky projekt do të duhet të marrë parasysh elementët e ndryshëm të diskutuar gjatë trajnimit (zbatimi i fazave të një projekti në klasë, një skenar edukativ duke përdorur mjete digjitale).

Pjesëmarrësve u kërkohej të jenë aktivë, krijues. Ata do të duhet të organizohen, të informohen, të prodhojnë, të shkëmbejnë, të përballen.




### Mbi trajnieren



**Prof. Asoc. Dr.  
Elona Toro**

- Elona Toro, pedagoge në Departamentin e gjuhës frënge të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës jep lëndët e Mësimdhënies nëpërmjet Teknologjive të Informacionit dhe të Komunikimit si dhe të Frëngjishtes me Qëllime Specifike.
- Ajo ka përfunduar studimet universitare në vitin 2005 në Departamentin Gjuhës Frënge në Universitetin e Tiranës në fushën e përkthimit dhe interpretimit. Më vonë, ajo ndoqi një master në Përhapjen e gjuhës frënge, Frankofoni në Universitetin e Rouen-it dhe një master 2 në Didaktikë të Gjuhës Frënge në Universitetin e Sorbonës – Paris III.
- Prof. Asoc. Dr. Elona ka mbrojtur tezën e doktoratës në vitin 2017 mbi një temë që lidhet me përdorimin e TIK-ut për të përmirësuar trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve të gjuhës: “TIK -u dhe ndërtimi i njohurive në kuadrin e trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve të gjuhëve në Shqipëri”.
- Gjatë karrierës së saj profesionale, pedagogja Elona Toro ka ndjekur dhe ofruar disa trajnime në lidhje me mësimin e FLE/FOS falë mjeteve digjitale dhe ka marrë pjesë në disa projekte, shkëmbime Erasmus, konferenca dhe për këto tema, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera të rajonit e më gjerë.

## *Moduli 5: Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në kompetenca, dhe planifikimi i veprimtarive mësimore sipas nevojave të veçanta dhe nivele të ndryshme gjuhësore*



**MODUL TRAJNIMI**

Kanë filluar regjistrimet për:

**MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT BAZUAR NË KOMPETENCA DHE PLANIFIKIMI I VEPRIMTARIVE MËSIMORE SIPAS NEVOJAVE TË VEÇANTA DHE NIVELEVE TË NDRYSHME MËSIMORE**

( 3 KREDITE )

Trajnues:

PROF. DR. ELIDA TABAKU  
PROF. ASOC. DR. MIGENA ALIMEHMETI  
PROF. ASOC. DR. AIDA GJINALI

**MË SKANO**

3 KREDITE=3000L

### **Titulli i programit të trajnimit:**

Mësimdhënia dhe të nxënit e bazuar në kompetenca, dhe planifikimi i veprimtarive mësimore sipas nevojave të veçanta dhe nivele të ndryshme gjuhësore

### **Lloji i Trajnimit:**

Trajnim i drejtpërdrejtë  
Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime  
Trajnimi nëpërmjet internetit

### **Nr i krediteve:**

54 orë – 3 kredite

## **Temat**

- Mësimdhënia me në qendër nxënësin, inteligjenca e shumëfishtë; Teknikat e zhvillimit të të menduarit kritik; Stilet e të nxënit dhe zbatimi i tyre në planifikim dhe mësim;
- Mësimdhënia e bazuar në detyra dhe në veprimtari gjithëpërfshirëse;
- Qëllimet mësimore të orës së mësimi dhe hapat e kryerjes së detyrave;
- Praktika të strukturimit dhe planifikimit të mësimi për klasa me nxënës me nevoja të veçanta me synim mbajtjen e tyre të interesuar në mësim;
- Strategjitë dhe stilet e mësimdhënies;
- Qasja bazuar në objektiva;
- Qasja bazuar në kompetenca;
- Kontributi respektiv i të dyjave qasjeve;
- Sfidat e mësimdhënies dhe nxënies në Klasat me nivele gjuhësore të diferencuara (KAD);
- Si të menaxhojmë klasat me aftësi dhe nivele të diferencuara;
- Zhvillimi i aftësive gjuhësore në klasat me nivele të diferencuara dhe zhvillimi i kompetencave gjuhësore në klasat me nivele të diferencuara;
- Të nxënit në bashkpunim; impostimi në klasat e gjuhës dhe faktorët diferencues gjuhësorë dhe jogjuhësorë në klasat KAD;
- Bazat teorike dhe operative të KAD;
- Aspekte konjitive dhe faktorët që përcaktojnë diferencat në KAD;
- Strategji të menaxhimit të klasave KAD, Karakteristikat e klasave KAD;
- Roli i mësuesit në klasat KAD;
- Teknika dhe materialet që propozohen për klasat e përziera KAD;
- Zhvillimi aftësive në klasat KAD.

## Rezultatet e pritshme

Në përfundim të modulit pjesëmarrësit do të:

- kenë rritur në një shkallë më të lartë vetëdijen e tyre në lidhje me planifikimin e mësimit bazuar në kompetencat, nevojat dhe nivelet e nxënësve;
- kenë pasuruar njohuritë mbi karakteristikat psikologjike të nxënësve dhe ecurinë e përvetësimit të gjuhës;
- jenë të aftë të përcaktojnë objektivat mësimore dhe të zhvillojë mësimin në përputhje me to.
- dinë të hartojnë plane mësimore të qarta në përputhje me nevojat mësimore të nxënësve;
- jenë në gjëndje të modifikojnë ushtrimet e librit në përputhje me nevojat gjuhësore të nxënësve;
- jenë të aftë të bëjnë analizën e teknikave të tyre të planifikimit të veprimtarive mësimore;
- jenë të aftë të përmirësojnë planifikimin me synim zhvillimin gjuhësor dhe të të menduarit kritik të nxënësve.
- dinë të përshtatin dhe krijojnë veprimtari mësimore që të mundësojnë përfshirjen e nxënësve më aftësi të veçanta në mësim;
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë që kanë mësuar në situata të reja dhe të panjohura;
- dinë të shfrytëzojnë dhe seleksionojnë materialet e ofruara nga ueb në lidhje me planifikimin.



## Metodologjia

Trajnimi do zhvillohet në mënyrë të kombinuar.

Moduli është një kombinim i teorisë me praktikën për të thelluar njohuritë gjuhësore dhe metodologjike si dhe për të zhvilluar më tej aftësitë e përdorimit të gjuhës dhe mësimdhënien e saj.

Në seancat e zhvillimit të modulit online, do të ketë prezantim nga trajnuesit.

Orët e tjera do të jenë diskutime dhe veprimtari praktike, ku të trajnuarit do diskutojnë dhe punojnë në grup 2-3 persona. Seancat online do të zhvillohen në TEAMS.

## Literatura e rekomanduar

Ann-Christin Svärd The challenge of mixed-ability classes –How should upper secondary English teachers work in order to help the weaker students?, Höstterminen 2006, fq 41- 60

F. Caon Educazione linguistica nella Classe ad Abilità Differenziate, Bonaci Editore. Fq 62- 90.

Tomlinson C.. The differentiated Classroom: Responding to the Needs of All learners. (Alexandria: ASCD).1999 45 – 78


Idrissa Assumani Zabo et Robert LOLEKONDA Kalonda. Enseignement, Apprentissage et Evaluation selon l 'Approche Par Compétences. VVOB. 2009

## Mbi trajnierin




**Prof. Dr.  
Elida Tabaku**

- Prof. Dr. Elida Tabaku është pedagoge e Didaktikës dhe Metodikës së gjuhës angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti I Tiranës.
- Prof. Dr. Elida Tabaku është eksperte në lëndët e metodologjise dhe didaktikës së gjuhëve të huaja. (lëndët Metodologji, psikolinguistikë, gjuhësi e zbatuar, metodat e kërkimit shkencor)
- Ajo është hartuese programesh në Ciklin e Parë dhe të Dytë të studimeve universitare.
- Ajo është autore e disa artikujve dhe kumtesave shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Prof. Dr. Elida Tabaku organizon dhe ndjekje e praktikave mësimore të studentëve të masterit Mësuesi.
- Ajo është autore e disa botimeve brenda dhe jashtë vendit në fushën metodikës dhe pedagogjisë së gjuhëve të huaja.



**Prof. Asoc. Dr.  
Migena Alimehmeti**

- Prof. Asoc. Dr. Migena Alimehmeti është Pedagoge e Didaktikës së gjuhës frënge në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.
- Prof. Asoc. Dr. Migena Alimehmeti është specialiste për lëndët në fushën e gjuhësisë dhe didaktikës së gjuhëve të huaja. (lëndët: morfologji, tipologji teksti, metodologji e punës universitare, laborator i kërkimit shkencor).
- Ajo është hartuese programesh në Ciklin e parë dhe të dytë të studimeve universitare.
- Prof. Asoc. Dr. Migena Alimehmeti është autore dhe bashkëautore e disa artikujve dhe kumtesave shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Ndjekje e praktikave mësimore të studentëve të masterit Mësuesi.
- Ajo ofron trajnime për çështje të metodologjisë së mësimdhënies, mendimit kritik, kodit të etikës.
- Ajo ka kryer studime Master në Administrim Publik.



**Prof. Asoc. Dr.  
Aida Gjinali**

- Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali është Pedagoge e Didaktikës së Gjuhëve të huaja, Gjuhë praktike, Tipologji teksti 2, 4 (Cikli I), Metoda dhe Metodologji e mësimdhënies (Cikli II), pranë FGJH-UT.
- Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali ndjek praktikat mësimore (Cikli II), gjuha italiane.
- Ajo është autore e shumë artikujve shkencorë brenda dhe jashtë vendit; Autore e shumë kumtesave në Konferenca, Kuvende, Seminare, Kongrese brenda dhe jashtë vendit.
- Autore e botimeve të teksteve mësimore për sistemin Universitar.
- Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali është pjesëmarrëse në shumë trajnime brenda dhe jashtë vendit me fokus mësimdhënien dhe të nxëniet.
- Anëtare e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulave, UT; Anëtare e Komisionit të vlerësimit të teksteve MASR, Anëtare e Komisionit të Doktoraturave, FGJH; Anëtare e NJSBS, FGJH.
- Ajo është eksperte e jashtme për akreditimet ASCAL.

## *Moduli 6: Përdorimi i platformës virtuale në mësimdhënie (Classroom, Zoom, Blogger) dhe Micro-Bit*



### **Titulli i programit të trajnimit:**

Përdorimi i platformës virtuale në mësimdhënie (Classroom, Zoom, Blogger) dhe Micro-bit

### **Lloji i Trajnimit:**

Trajnim i drejtpërdrejtë

Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime

Trajnimi nëpërmjet internetit

### **Nr i krediteve:**

18 orë – 1 kredit


## **Temat**

- Hyrje: Prezantimi i përfitimeve të klasës digjitale dhe njohja me platformën Google Classroom;
- Hapat për krijimin e klasës; postimi i detyrave, testeve dhe formave të tjera të vlerësimit dhe postimi i tyre në platformë; korrigjimi dhe dorëzimi i tyre tek nxënësit;
- Prezantimi i konceptit të Cloud Storage dhe Google Drive;
- Krijimi dhe administrimi i takimeve online me Google Meet;
- Prezantimi i funksioneve kryesore të Zoom-it;
- Mjetet e menaxhimit të klasës; mjetet për krijimin e klasave ndërvepruese dhe për angazhimin e nxënësve;
- Krijimi i një hapësire të sigurtë dhe mbështetëse për nxënësit nëpërmjet cilësimeve të parametrave të sigurisë në Zoom;
- Prezantimi i programit Blogger; përfitimet e përdorimit të tij në mësimdhënie;
- Udhëzime dhe sugjerime për mënyra të ndryshme të përdorimit të Blog-ut si mjet mësimor;
- Përgatitja e orëve mësimore ndërvepruese: krijimi i planeve dhe programeve mësimore të përbashkëta; hartimi dhe shpërndarja e materialeve mësimore në platformat virtual.


## Rezultatet e pritshme

Pjesëmarrësit pas përfundimit të trajnimit:

- kuptojnë përfitimet dhe avantazhet e përdorimit të platformave virtuale në mësimdhënie;
- prezantojnë dhe integrojnë platformat virtuale në klasat e tyre fizike e tradicionale;
- ndërtojnë klasa tërësisht virtuale me të gjithë elementët e një mësimi tradicional të zhvendosur në një kontekst virtual;
- hartojnë plane mësimore për orë mësimore të zhvilluara nëpërmjet platformave virtuale;
- hartojnë plane të përbashkëta mësimore me mësuesit e tjerë;
- hartojnë, postojnë, korrigjojnë dhe japin vlerësimin e detyrave dhe testeve në platformën virtuale;
- organizojnë orë mësimore virtuale nëpërmjet programeve dhe cilësimeve të ofruara nga platformat përkatëse;
- të dinë të përdorin paisjen Micro:bit dhe të mund t'a integrojnë atë në përditshmërinë tyre.



Blogger



## Metodologjia

Gjatë trajnimit të drejtpërdrejt do të përdoren metodat e mëposhtme të trajnimit:

- përgatitja e PPT, ku demonstrohen të gjitha hapat për krijimin e platformave dhe përdorimit të tyre;
- live tutorial nga trajneri për përdorimin e Micro:bit;
- diskutime dhe eksperimentime të aftësive të përfutuara gjatë trajnimit;
- punë e pavarur individuale për realizimin e detyrave të caktuara;
- punë në grupe të vogla për realizimin e projekteve;
- punë e pavarur individuale për përvetësimin dhe praktikimin e të gjitha aftësive të përfutuara lidhur me platformat individuale;
- analizë e diskutime mbi materialet audio e video që do t'ju vihen në dispozicion nga trajnerët mbi mënyrat e përdorimit, integritit dhe përshtatjes për përdorim të platformave dhe Micro-bit edhe nga nxënësit;
- materiale audio e video që mund të prodhohen nga pjesëmarrësit gjatë trajnimit por edhe si detyra shtëpie në formën e një projekti përfundimtar.

## Literatura e rekomanduar

Manual i përdorimit të platformës Google Classroom

[https://services.google.com/fh/files/misc/google\\_classroom\\_user\\_guide.pdf](https://services.google.com/fh/files/misc/google_classroom_user_guide.pdf)

Google Forms: Krjimi, Editimi dhe Shpërndarja

<https://www.uww.edu/Documents/icit/documentation/Google/ICITGoogle%20>

Manual për Mësuesit mbi Përdorimin e Zoom-it në Klasë

<https://explore.zoom.us/docs/en-us/educator-guide.html>

<https://explore.zoom.us/docs/doc/Education%20Guide%20%20Getting.pdf>

Attention, Educators! New Ways to Enhance Classroom Engagement and Simplify Administration

<https://blog.zoom.us/new-enhance-classroom-engagement-simplify-administration/>


Shkrimi i një Blog-u me programin Blogger.com: Manual udhëzues

<https://www.youtube.com/watch?v=U2QvwgaECps>

Churchill, D. (2009). Educational applications of Web 2.0: Using blogs to support teaching and learning. British Journal of Educational Technology, 40(1), 179-183.




## Mbi trajnierët



**Prof. Asoc. Dr.  
Daniela Hasa**


- Prof. Asoc. Dr. Daniela Hasa është pedagoge me kohë të plotë në Departamentin e Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës. Në ciklin e parë të studimeve ajo mbulon lëndët e Hyrjes në Gjuhësi, Gjuhës së Sotme B dhe Varianteve të Gjuhës Angleze, ndërsa në ciklin e dytë të studimeve mbulon lëndën e përdorimit të TIK në mësimdhënien e gjuhës së huaj.
- Prof. Asoc. Dr. Daniela ka një përvojë të gjatë në mësimdhënien e gjuhës së huaj dhe përdorimin e metodave sa më të larmishme me qëllim motivimin dhe angazhimin e nxënësve.
- Ajo është e përfshirë në ndjekjen e praktikave mësimore të studentëve të masterit Mësuesi dhe është autore e disa artikujve dhe kumtesave shkencore brenda dhe jashtë vendit në lidhje me këtë temë.
- Gjithashtu, ajo është e pajisur me certifikatë si trajnuese e mësuesve të gjuhës së huaj nga organizata ndërkombëtare e mësuesve të gjuhës së huaj TESOL dhe me certifikatë si trajnuese dhe vlerësuese nga Fortress Learning, Australi.



**Prof. Asoc. Dr.  
Ogerta Stroka (Koruti)**

- Ogerta Koruti Stroka është profesoreshë e Shkencave në Gjuhësi dhe Mësimdhënie në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës.
- Prof. Asoc. Dr. Ogerta është pedagoge në Universitetin e Tiranës që nga viti 2005 e në vazhdim. Që prej vitit 2021 ajo është Zv Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.
- Fusha e saj e ekspertizës është integrimi i teknologjive të reja në mësimdhënie.
- Ajo është E- Moderator, Master Trainer dhe Validator për British Council UK për Core Skills si Digital Literacy, Leadership Citizenship, Critical thinking, Problem Solving and Decision Making, Collaboration and Communication, Creativity and Imagination, Personal Development si edhe Presentation Skills.

## *Moduli 7: Testimi dhe vlerësimi i të nxënit si dhe nxitja e autonomisë së nxënësit bazuar në portofolin PEGJH*



### **Titulli i programit të trajnimit:**

Testimi dhe vlerësimi i të nxënit si dhe nxitja e autonomisë së nxënësit bazuar në portofolin PEGJH

### **Lloji i Trajnimit:**

Trajnim i drejtpërdrejtë

Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime

Trajnimi nëpërmjet internetit

### **Nr i krediteve:**

54 orë – 3 kredite

## **Temat**

- Prezantimi i Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPERGJ)- mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi, si dokument prej të cilit buron dhe ka origjinën PEGJ;
- Prezantimi i Portofolit Evropian të Gjuhëve (PEGJ) dhe e pjesëve të tij përbërëse;
- Politikat gjuhësore të Këshillit të Evropës dhe nevoja e përdorimit të KPER dhe PEGJ në institucionet Arsimore;
- Lidhja e programeve të gjuhëve të huaja me KPERGJ. Kompetencat e përgjithshme dhe ato të fushës sipas KPERGJ dhe PEGJ;
- Paraqitje e Shkallës globale të niveleve të gjuhëve të huaja. Përshkruarit e niveleve sipas kompetencave gjuhësore e kulturore nga A1 në C2;
- Lidhja midis PEGJ dhe Kuadri të Përbashkët Evropian të Referencave si një mjet i domosdoshëm për përdorimin e llojeve të vlerësimit të të nxënit;
- Portofoli evropian i gjuhëve – një dokument që i përket nxënësit, mënyra e përdorimit nga nxënësit;
- Funksionet pedagogjike e socio-kulturore të PEGJ dhe veprimtari që mund të organizojë mësuesi në klasë;
- Portofoli Evropian i Gjuhëve – pronë e nxënësve dhe një dokument bazë i vetëvlerësimit të arritjeve të tyre në nxënien e gjuhëve të huaja;
- Dosja si pjesë përbërëse e Portofolit, funksionet dhe përmbajtja e saj;
- Nxitja e vetëvlerësimit në nxënien e gjuhës sipas niveleve evropiane nëpërmjet përcaktimit të kriterëve transparente për të gjithë nxënësit;
- Problemet e testimit gjuhësor në klasat e gjuhëve të huaja;
- Vlerësimi dhe matja e njohurive dhe përvetësimi i aftësive gjuhësore sipas nivele të KPERGJ;
- Vlerësimi dhe matja e gabimit në testet e ndryshme sipas specifikës dhe objektit që ato testojnë;
- Vlerësimi dhe teknologjitë në kohën e re me të cilën përballët sot mësimdhënia;
- Teknikat e Language testing si bazë mbështetëse për ndërtimin dhe hartimin e testeve të ndryshme sipas nivele të përcaktuara nga KPERGJ.

## Rezultatet e pritshme

Pjesëmarrësi do të jetë i aftë të:

- a) interpretojë synimet e Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave;
- b) analizojë lidhjen mes Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave me Kornizën Kurrikulare, Kurrikulat Bërthamë dhe programet e lëndës “Gjuhë e huaj”;
- c) analizojë lidhjen midis kompetencave kyçe dhe ato të lëndës, veprimtarive gjuhësore, aftësive dhe strategjive që duhen përdorur në aspekte të ndryshme të mësimdhënies së gjuhës së huaj
- d) shqyrtojë elementet dhe rritë e Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave në hartimin e programeve dhe planeve mësimore;
- e) analizojë elementet dhe metodologjinë që përdoret për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e kompetencave gjuhësore e komunikative;
- f) realizojë lidhjen e gjuhës së huaj me tema ndërkurrikulare si dhe organizimin e projekteve të përbashkëta;
- g) vlerësojë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet për çdo kompetencë dhe veprimtari gjuhësore;
- h) rrisë motivimin e nxënësve për të vlerësuar progresin e tyre gjuhësor duke e bazuar atë në standardet Evropiane;
- i) përcaktojë nivelet e arritjes të nxënësve dhe harton teste vlerësimi të standardizuara;
- j) përdorë llojet e ndryshme të vlerësimit si mjet pedagogjik motivues;
- k) vlerësojë aftësitë ligjërimore të nxënësve sipas standardeve evropiane;
- l) hartojë instrumente matëse në përputhje me nivelet dhe objektivat e mësimdhënies;
- m) përcaktojë kritere të qarta vlerësimi në funksion të rritjes së transparencës dhe objektivitetit;
- n) dijë të përdori vetëvlerësimin për ndërgjegjësimin e nxënësve në lidhje me njohuritë dhe kompetencat e tyre.

## Metodologjia

Metodat gjatë trajnimit:

Gjatë trajnimit do të përdoren forma e metoda të larmishme leksione, debate, diskutime:

- Nxitja e reflektimit në auditor dhe shfrytëzimi dhe shkëmbimi i përvojës së mësuesve.
- Punë me grupe, diskutim e debat për raportimin e punës së grupit.
- Analizë e diskutime mbi materialet audio e video që do të paraqiten.
- Simulim në auditor i një aspekti të Portofolit për të parë konkretisht se si punohet dhe se si lidhet Portofoli me tekstin shkollor.

Përveç paraqitjes së temave teorike/praktike të lartpërmendura fokusi gjatë takimeve të drejtpërdrejta do të jetë diskutimi i hapur ku trajnuesi dhe pjesëmarrësit do të parashtrojnë hipoteza dhe do të trajtojnë çështje lidhur me temën apo nënçështjet specifike lidhur me të.

Debati dhe diskutimi do të shtrohet jo vetëm mbi anën teorike të saj por kryesisht mbi përvojat praktike të vetë pjesëmarrësve, problematikat, hapat e ndjekur për t’i zgjidhur ato dhe sa ka qenë e mundshme zgjidhja e tyre.

Gjatë trajnimit të drejtpërdrejtë fokusi do të ndalet dhe në punën konkrete të konceptuar si punë në grup apo individuale duke pasur parasysh udhëzimet e dhëna dhe informacionet e marra gjatë trajnimit.

Trajnimi i drejtpërdrejtë do të konceptohet si një bashkëpunim frytdhënës dhe shkëmbim informacionesh dhe të dhënash të nevojshme për të ofruar dhe për të marrë informacione të nevojshme për hartimin e testeve të ndryshme për një vlerësimin efikas dhe në lidhje me analizën e gabimeve. Gjatë trajnimeve të drejtpërdrejta do të eksperimentohet në mënyrë konkrete mbi teste që mund të krijohen në lidhje me nevojat për informacion që ka mësuesi në lidhje me objektivat e lëndës.

## Literatura e rekomanduar

- Kuadri i Përbashkët European i References për Gjuhët, botim i Këshilli i Europës, Didier 2001.  
<https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/2018-KUADRI-I-PERBASHKET-EUROPIAN-.pdf>
- Tekstet shkollore që përdoren në shkollat tona fillore, 9 vjeçare e të mesme. - Kurrikula kombëtare e gjuhëve të huaja.  
<https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2018/09/Gjuhe-e-huaj-niveli-avancuar.pdf>
- Programet shkollore të sistemit parauniversitar <https://www.ascap.edu.al/?s=programet+>
- Standardet e aritjeve për nxënësit e arsimit parauniversitar. <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Korniza-e-vleresimit-te-nxenesit-23-korrik-2015.pdf>
- Portfolio européen des langues : pour jeunes et adultes Conseil de l'Europe. Didier, 2001.
- Portfolio européen des langues : collège Conseil de l'Europe. Didier, 2004.
- Comoglio M., 2002a, La "valutazione autentica", "Orientamenti Pedagogici", 49 (1), pp. 93-112.  
[www.irre.lombardia.it/portfolio/Valutazione autentica Comoglio.doc](http://www.irre.lombardia.it/portfolio/Valutazione%20autentica%20Comoglio.doc)
- G. Porcelli (2002) Educazione linguistica e valutazione, Utet libreria, Torino. 39- 53


## Mbi trajnerët



**Prof. Dr.**

**Andromaqi Haloçi**

- Prof. Dr. Andromaqi Haloçi është Pedagoge e Didaktikës së gjuhës frënge në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.
- Prof. Dr. Andromaqi Haloçi është specialiste e lëndëve Didaktikë dhe Metodikë e gjuhëve të huaja si edhe Psikolinguistikë.
- Ajo është eksperte e vlerësimit dhe hartimit të testeve për provimet dhe certifikimet në gjuhën frënge.
- Prof. Dr. Andromaqi ndjek praktikat pedagogjike të studentëve.
- Ajo është autore e disa botimeve brenda dhe jashtë vendit në fushën metodikës dhe pedagogjisë së gjuhëve të huaja.
- Prof. Dr. Andromaqi Haloçi është trajnuese kombëtare dhe ndërkombëtare e angazhuar nga qendrat si ASCAP, Tiranë dhe CREFECO dhe OIF (Qendra Rajonale e Europës Juglindore dhe Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë).



**Prof. Asc. Dr.**  
**Aida Gjinali**

- Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali është Pedagoge e Didaktikës së Gjuhëve të huaja, Gjuhë praktike, Tipologji teksti 2, 4 (Cikli I), Metoda dhe Metodologji e mësimdhënies (Cikli II), pranë FGJH-UT.
- Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali ndjek praktikat mësimore (Cikli II), gjuha italiane.
- Ajo është autore e shumë artikujve shkencorë brenda dhe jashtë vendit; Autore e shumë kumtesave në Konferenca, Kuvende, Seminare, Kongrese brenda dhe jashtë vendit.
- Autore e botimeve të teksteve mësimore për sistemin Universitar.
- Prof. Asoc. Dr. Aida Gjinali është pjesëmarrëse në shumë trajnime brenda dhe jashtë vendit me fokus mësimdhënien dhe të nxënës.
- Anëtare e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulave, UT; Anëtare e Komisionit të vlerësimit të teksteve MASR, Anëtare e Komisionit të Doktoraturave, FGJH; Anëtare e NJSBS, FGJH. Ajo është eksperte e jashtme për akreditimet ASCAL.

## *Moduli 8: Menaxhimi i klasës dhe i konflikteve, mirëqënia e nxënësve në klasë*



### **Titulli i programit të trajnimit:**

Menaxhimi i klasës dhe i konflikteve, mirëqënia e nxënësve në klasë

### **Lloji i Trajnimit:**

Trajnim i drejtpërdrejtë

Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime

Trajnimi nëpërmjet internetit

### **Nr i krediteve:**

36 orë – 2 kredite


### **Temat**

- Rëndësia e menaxhimit efektiv të mësimit në klasë. Hartimi i një plani për menaxhimin e mirë të klasës;
- Inkurajimi i sjelljes shoqërore në klasë;
- Mbështetja e kohës mësimore përmes pritshmërive, mësimdhënies inkurajuese dhe korigjuese;
- Mbikëqyrja aktive e nxënësve;
- Ndarja dhe zgjedhja e detyrave/punëve në klasë;
- Dekurajimi i sjelljeve shqetësuese e konfliktuale;
- Përkufizimi i termit “mirëqenie e studentëve”;
- Rëndësia e mirëqenies së studentëve në klasë;
- Faktorët që ndikojnë pozitivisht dhe ata që ndikojnë negativisht në mirëqenien dhe performancën e mësuesve dhe nxënësve;
- Ndikimi i mirëqenies së mësuesve në mirëqenien e nxënësve.

## Rezultatet e pritshme

Në përfundim të kursit pjesëmarrësit:

- do të kenë një shpjegim të qartë të strategjive pozitive dhe proaktive për krijimin e një mjedisi mësimor efektiv dhe do të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë e tyre;
- do të jenë të aftë të përcaktojnë pritshmëritë dhe procedurat e një plani menaxhimi efektiv;
- do të inkurajojnë sjelljen e duhur në klasë dhe dekurajojnë sjelljet e papërshtatshme;
- do të demonstrojnë mbikëqyrje aktive të nxënësve në klasë;
- do të jenë të aftë të përdorin një sërë strategjish për t'iu përgjigjur më së miri nevojave të procesit mësimor;
- do të jenë të aftë të përdorin në mënyrë selektive aktivitetet e planifikuara dhe t'i përzgjedhin ato sipas nevojës për të mbajtur vazhdimisht të angazhuar nxënësit.



## Metodologjia

Trajnimi do zhvillohet në mënyrë të kombinuar.

Gjashtë seanca do të zhvillohen në auditor për të mundësuar shkëmbimin e përvojave në lidhje me strategjitë e menaxhimit të klasës. Gjashtë seanca do të zhvillohen në auditor për të diskutuar në lidhje me mirëqënien e nxënësve dhe mësuesve dhe faktorët që promovojnë atë. Çdo ditë të zhvillimit të modulit online do të ketë prezantim nga trajnuesit. Orët e tjera do të jenë diskutime dhe veprimtari praktike, ku pjesëmarrësit do të diskutojnë e punojnë në grupe me 2-3 persona. Seancat online do të zhvillohen në TEAMS.

-Materialet e prezantimit do të dërgohen më parë me e-mail, me qëllim që të garantohej një diskutim më i mirë nga pjesëmarrësit.

Përshkrimi i konkretizuar i mjeteve mësimore.

- Postera për zhvillimin e diskutimit;
- Piktura, flipçarte, grafikë;
- Celularët dhe aplikacioni Teams;
- Audiovizuale (filma dhe video);
- Ppt;
- Materiale të përgatitura për pjesëmarrësit;
- Ppt për leksionet që do të jepen;

Detyra për të trajnuarit, për t'i kryer gjatë ose/dhe pas modulit.

# Bibliografia kryesore e përdorur për të hartuar modulin

Scott, T. M. Anderson, C. M., & Alter, P. (2012). Managing classroom behavior using positive behavior supports. Upper Saddle River, NJ: Pearson Education, Inc.

Good, T. J., & Brophy, J. (2000). Looking into classrooms (8th Ed.) New York, NY: Longman Press.

Davis, S. (2007). Schools where everyone belongs: Practical strategies for reducing bullying. Champaign, IL: Research Press.



## Mbi trajnerët



**Prof. Asoc. Dr. Leonora Xhori**

- Dr. Leonora Xhori është Pedagoge e Sintaksës angleze, Metodologjisë së mësimin të gjuhës angleze.
- Dr. Leonora Xhori është specialiste e lëndës Metodikë e gjuhëve të huaja.
- Ajo është eksperte e vlerësimit të testeve për provimet dhe certifikimet në gjuhën angleze.
- Ajo bën ndjekje të praktikave pedagogjike të studentëve të programit Master në mësuesi (gjuhë angleze).
- Autore e disa botimeve brenda dhe jashtë vendit në fushën e gjuhësisë dhe pedagogjisë së gjuhëve të huaja.
- Dr. Leonora Xhori është pjesëmarrëse në konferenca e trajnime te ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare me fokus mësimdhënien.



**Prof. Dr. Elida Tabaku**

- Prof. Dr. Elida Tabaku është pedagoge e Didaktikës dhe Metodikës së gjuhës angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti I Tiranës.
- Prof. Dr. Elida Tabaku është eksperte në lëndët e metodologjisë dhe didaktikës së gjuhëve të huaja.  
(lëndët Metodologji, psikolinguistikë, gjuhësi e zbatuar, metodat e kërkimit shkencor)
- Ajo është hartuese programesh në Ciklin e Parë dhe të Dytë të studimeve universitare.
- Ajo është autore e disa artikujve dhe kumtesave shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Prof. Dr. Elida Tabaku organizon dhe ndjekje e praktikave mësimore të studentëve të masterit Mësuesi.
- Ajo është autore e disa botimeve brenda dhe jashtë vendit në fushën metodikës dhe pedagogjisë së gjuhëve të huaja.

## Moduli 9: Integrimi i koncepteve të barazisë gjinore në mësimdhënie



### Titulli i programit të trajnimit:

Integrimi i koncepteve të barazisë gjinore në mësimdhënie

### Lloji i Trajnimit:

Trajnim i drejtpërdrejtë

Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime

Trajnimi nëpërmjet internetit

### Nr i krediteve:


18 orë – 1 kredit

### Temat

- 1 – Barazia midis grave dhe burrave;
- 2 – Stereotipet gjinore dhe paragjykimet për gratë dhe burrat;
- 3 – Barazia në klasë, në shkollë dhe në komunitet;
- 4 – Reflektime dhe praktika.

### Rezultatet e pritshme

- të promovojë praktika arsimore, që në moshë të re dhe gjatë gjithë jetës, pa stereotipe seksiste duke rrënjësuar parimin e barazisë midis grave dhe burrave;
- të ndihmojë në rishikimin e rregullt të kurrikulave shkollore, tekstet shkollore dhe metodat e mësimdhënies në mënyrë që të eliminohen stereotipet seksiste dhe të promovohet barazia midis grave dhe burrave;
- të rrisë kapacitete që lidhen me barazinë mes vajzave dhe djemve në arsim.



## Metodologjia

Trajnimi do të organizohet në formën e një prezantimi të elementeve të ndryshëm të cilat lidhen me konceptet e barazisë gjinore në klasë.

Në përpjekje për të krijuar një dinamikë ndërveprimi gjatë trajnimit, pjesëmarrësve do t'u kërkohej t'u përgjigjen pyetjeve dhe të bëjnë brainstorming përmes mjeteve online.

Një kohë pyetje dhe përgjigje do t'u kushtohet nxënësve në fund të çdo teme.

Trajnimi në thelb bazohet në metoda mësimore aktive dhe pjesëmarrëse. Një pjesë e madhe e trajnimit do t'i kushtohet praktikimit të koncepteve të paraqitura nga trajneri nëpërmjet aktiviteteve mësimore në formën e Punës Praktike.

Detyrat do të organizohen rreth një aktiviteti qendror për çdo temë.


Pjesëmarrësve u kërkohej të jenë aktivë, krijues.

Kërkohej një alternim i punës në çift ose trinom (në varësi të numrit të pjesëmarrësve) dhe punës në grup. Trajnuesi punon në një grup për konsultimin dhe përvetësimin e një burimi të modulit. Ai e diskuton atë brenda grupit. Shkëmbimet brenda ekipit duhet të çojnë në zhvillimin dhe dorëzimin e një dokumenti përmbledhës të ekipit.

Pjesëmarrësve do t'u kërkohej pjesëmarrja aktive në një platformë bashkëpunimi dhe ndarjeje në mënyrë që të komentojnë prodhimet e paraqitura nga të gjitha ekipet .



## Mbi trajnerin



**Prof. Asoc. Dr.  
Elona Toro**

- Elona Toro, pedagoge në Departamentin e gjuhës frënge të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës jep lëndët e Mësimdhënies nëpërmjet Teknologjive të Informacionit dhe të Komunikimit si dhe të Frëngjishtes me Qëllime Specifike.
- Ajo ka përfunduar studimet universitare në vitin 2005 në Departamentin Gjuhës Frënge në Universitetin e Tiranës në fushën e përkthimit dhe interpretimit. Më vonë, ajo ndoqi një master në Përhapjen e gjuhës frënge, Frankofoni në Universitetin e Rouen-it dhe një master 2 në Didaktikë të Gjuhës Frënge në Universitetin e Sorbonës – Paris III.
- Prof. Asoc. Dr. Elona Toro ka mbrojtur tezën e doktoratës në vitin 2017 mbi një temë që lidhet me përdorimin e TIK-ut për të përmirësuar trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve të gjuhës: “TIK -u dhe ndërtimi i njohurive në kuadrin e trajnimit të vazhdueshëm të mësuesve të gjuhëve në Shqipëri”.
- Gjatë karrierës së saj profesionale, pedagogja Elona Toro ka ndjekur dhe ofruar disa trajnime në lidhje me mësimin e FLE/FOS falë mjeteve digjitale dhe ka marrë pjesë në disa projekte, shkëmbime Erasmus, konferenca dhe për këto tema, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera të rajonit e më gjerë.

# —Moduli 10: Teknikat e të pyeturit dhe diskutimi



**MODUL TRAJNIMI**

Kanë filluar regjistrimet për:

**TEKNIKAT E TË PYETURIT DHE DISKUTIMI**

(2 KREDITE)

Trajnues:  
PROF. DR. ELIDA TABAKU  
PROF. ASOC. DR. HATIXHE SEJDINI

**MË SKANO**

2 KREDITE=2000L

## **Titulli i programit të trajnimit:**

Teknikat e të pyeturit dhe diskutimi

## **Lloji i Trajnimit:**

Trajnim i drejtpërdrejtë

Trajnimi nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime

Trajnimi nëpërmjet internetit

## **Nr i krediteve:**

36 orë – 2 kredite

## **Temat**


- Qëllimet e përdorimit të pyetjeve në mësimin e gjuhës së huaj dhe përvetësimit të teknikave të të pyeturit;
- Nivelet e pyetjeve sipas Bloom;
- Parimet e të pyeturit;
- Ndërtimi i pyetjeve dhe koha e pritjes;
- Vlerësim dhe Vetëvlerësimi i pyetjeve që përdorim në klasë;
- Trajtimi i përgjigjeve të nxënësve;
- Bërja e pyetjeve nga nxënësit;
- Diskutimi në klasë;
- Strategjitë për vazhdimin e diskutimit;
- Vetëvlerësimi i arritjeve në modul dhe vlerësimi i modulit.



## Rezultatet e pritshme

Në përfundim të kursit pjesëmarrësit do të:

- kenë zhvilluar vetëdijen e tyre në lidhje me llojin e pyetjeve dhe teknikat e të pyeturit në mësimin e gjuhës së huaj;
- jenë të aftë të bëjnë analizën e teknikave të tyre të pyetjeve;
- dinë të identifikojnë tiparet kryesore të pyetjeve të mira që ndikojnë në një mësim më cilësor;
- jenë të aftë të përmirsojnë planifikimin dhe përdorimin e pyetjeve me synim “Zhvillimin gjuhësor dhe të menduarit kritik të nxënësve”;
- dinë të përshtasin dhe krijojnë veprimtari mësimore të mbështetura në pyetje që nxisin diskutime;
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë që kanë mësuar në situata të reja dhe të panjohura;
- mësojnë të modelojnë dhe angazhojnë nxënësit në bërjen e pyetjeve;
- identifikojë mënyrat përkatëse për zhvillimin profesional (në lidhje me pyetjen), të cilat mund t'i ndjekin më pas.



## Metodologjia

Metodat gjatë trajnimit (për trajnimin nëpërmjet internetit i kombinuar me konsultime):

- Trajnimi do zhvillohet në mënyra të kombinuar;
- Shkëmbimi i përvojave në lidhje me teknikat e të pyeturit, për të forcuar njohjen midis pjesëmarrësve dhe për të patur më të qartë detyrat e këtij moduli.
- Orët e tjera do të jenë diskutime dhe veprimtari praktike, ku pjesëmarrësit do të diskutojnë dhe do të punojnë në grupe me nga 2-3 persona.
- Seancat online do të zhvillohen në TEAMS.
- Materialet e prezantimit do të dërgohen më parë në email, me qëllim që të sigurohet një diskutim më i mirë nga pjesëmarrësit.


## Literatura e rekomanduar

Brookfield, S. D. & Preskill, S. (1999) Discussion as a Way of Teaching: Tools and Techniques for Democratic Classrooms. San Francisco: Jossey-Bass.

Fusco Esther Effective Questioning Strategies in the Classroom: A Step-by-Step Approach to Engaged Thinking and Learning, K-8 Teachers College Press, 2012

McNaughton, S. & Lai, M. (2012). Testing the effectiveness of an intervention model based on data use: a replication series across clusters of schools. School Effectiveness and School Improvement. 23(2), 203-228.

Wragg, E.C. (Edward Conrad). Questioning in the Secondary School London ; New York : Routledge/Falmer, 2001



### Mbi trajnierin



**Prof. Dr.  
Elida Tabaku**

- Prof. Dr. Elida Tabaku është pedagoge e Didaktikës dhe Metodikës së gjuhës angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Universiteti I Tiranës.
- Prof. Dr. Elida Tabaku është eksperte në lëndët e metodologjise dhe didaktikës së gjuhëve të huaja.  
(lëndët Metodologji, psikolinguistikë, gjuhësi e zbatuar, metodat e kërkimit shkencor)
- Ajo është hartuese programesh në Ciklin e Parë dhe të Dytë të studimeve universitare.
- Ajo është autore e disa artikujve dhe kumtesave shkencore brenda dhe jashtë vendit.
- Prof. Dr. Elida Tabaku organizon dhe ndjekje e praktikave mësimore të studentëve të masterit Mësuesi.
- Ajo është autore e disa botimeve brenda dhe jashtë vendit në fushën metodikës dhe pedagogjisë së gjuhëve të huaja.



**Prof. Asoc. Dr.  
Hatixhe Sejdini**

- Prof. Asoc. Dr. Hatixhe Leka (Sejdini) është e punësuar me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhës Angleze, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.
- Prof. Asoc. Dr. Hatixhe Leka (Sejdini) ka një përvojë pune 20 vjeçare si pedagoge dhe studiuese. Pas diplomimit në “Studime Britanike dhe Amerikane” në vitin 2001, përfundon studimet pasuniversitare dhe ato doktorale në fushën e gjuhësisë, sintaksë angleze.
- Ajo merret me fushat e mësimdhënies dhe ekspertizës kërkimore përfshijnë gjuhësinë, pedagogjinë dhe kërkimin shkencor.
- Prof. Asoc. Dr. Hatixhe Leka (Sejdini) ka marrë pjesë në seminare, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare lidhur me fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze, përdorimin e teknologjisë në mësimdhënien e gjuhës angleze, aplikimin e metodologjive të kërkimit shkencor etj.
- Ajo ka botuar artikuj shkencorë që lidhen me fushat e mesimdhënies dhe punës kërkimore si brenda dhe jashtë vendit.



# AUF



[WWW.FGJH.EDU.AL](http://WWW.FGJH.EDU.AL)



FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA I UT-SË - FAQJA ZYRTARE



[FAKULTETI.GJUHEVETEHUAJA.UT](https://www.instagram.com/fakulteti.gjuheveteHUAJA.UT)